

## CIA EXAM REVIEW PART 1

**Data:** 09 – 10 Prill 2018 (2 ditë)  
**Koha:** 09:00 – 17:00  
**Vendndodhja** Hotel Grand, Tiranë  
**Instruktor** Stavri Pashko, CIA

### Hyrje

Çertifikimi për auditimin e brendshëm CIA® , është një certifikim i lëshuar nga Instituti Global i Audituesve të Brendshëm dhe si i tillë është i vetmi certifikim mbi auditimin e brendshëm i njohur në nivel ndërkombëtar. Kërkime të kryera nga Global IIA, kanë treguar që profesionistët e certifikuar me CIA kanë rezultate më të mira, një karrierë më të sukseshme dhe përfitime më të mëdha ekonomike dhe profesionale.

Ky trajnim përgatitor është hartuar për të ndihmuar kandidatët që të kuptojnë temat e trajtuara në provimin e parë për çertifikimin CIA. Kursi do të bazohet në programin e studimit IIA Learning, një kurrikulum i zhvilluar nga vetë IIA Global ([www.learnCIA.com](http://www.learnCIA.com)).

I udhëhequr nga instruktorë të certifikuar, kursi është hartuar për të dhënë një analizë të plotë, për të forcuar njohuritë, për të sqaruar dhe më tej temat përkatëse si dhe për të rritur vetbesimin tuaj për të kaluar me sukses provimin. Për më shumë info mbi çertifikimin ndërkombëtar CIA, [klikoni këtu](#).

### Ftesë për pjesëmarrje

Ky trajnim është i përshtatshëm për kandidatë të CIA-s, auditues të brendshëm që kërkojnë mundësi zhvillimi profesional, studentë të kontabilitetit, ekonomikut ose të financës.

### Cfarë do të përfitoni?

Gjatë këtij kursi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Diskutojnë midis tyre dhe me instruktorët temat ku ata/ato hasin vështirësi
- Marrin këshilla dhe metoda sesi të zhvillojnë provimin brenda kohës së caktuar
- Praktikojnë me pyetje të ngjashme si ato të provimit

### ***Kini parasysh:***

***Duke qënë se provimet jepen në gjuhën angleze, gjuha angleze është kërkesë për pjesëmarrjen në këtë seminar. Kandidatët janë të ftuar të lexojnë materialet e studimit të paktën një herë para se të marrin pjesë në seminar.***

## **DITA 1**

### **9:00 - 10:30**

- Hyrje
- Identifikimi dhe pranimi i objektivave të trajnimit
- Përshkrimi i programit CIA
- Këshilla dhe sugjerime mbi mënyrën e trajtimit të materialeve
- Menaxhimi i kohës së studimit dhe provimit
- Pyetje dhe përgjigje

### **10:30 – 10:45 PUSHIM KAFEJE**

### **10:45 – 12:30**

Pjesa I: Udhëzime të detyrueshme

- **Kapitulli A Përkufizimi i auditimit të brendshëm**
- Shpjegim të përkufizimit të auditimit të brendshëm
- Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e funksionit të auditimit të brendshëm
- Ushtrime <sup>1</sup>
- **Kapitulli B: Kodi i Etikës of Ethics**
- Hyrje dhe shpjegim të Kodit të Etikës
- Ushtrime
- **Kapitulli C: Standartet Ndërkombëtare**
- Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare
- Mirëmbajtja e Pavarësisë dhe Objektivitetit
- Ushtrime
- Përcaktimi i aftësive dhe kompetencës së nevojshme për funksionin e auditimit të brendshëm
- Vlerësoni performancën e funksionit të auditimit të brendshëm
- Kujdesja e duhur profesionale e audituesit të brendshëm
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional
- Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i funksionit të auditimit të brendshëm

Ushtrime dhe Diskutime

### **12:30 - 13:30 DREKA**

---

<sup>1</sup> Gjatë ushtrimeve do praktikohen: pyetjet më të shpeshta (ku duhet fokusuar), gabimet që kandidatët mund të bëjnë gjatë seancës së provimit, temat më të ndërlikuara etj.

**13:30 – 15:30**

Pjesa II: Kontrolli i Brendshëm dhe Risku

- **Kapitulli A: Llojet e kontrolleve dhe teknikat e kontrollit menaxherial**
- Përshkruani llojet e kontrolleve
- Përshkruani llojet e teknikave të kontrollit menaxherial
- **Kapitulli B: Karakteristikat e kornizave të kontrollit të brendshëm dhe përdorimi i tyre**
- Shpjegimi i kornizës së kontrollit të brendshëm të integruar COSO
- Korniza të tjera të kontrollit të brendshëm
- Ushtrime
- Kapitulli C: Fjalori i riskut dhe koncepte
- Shpjegim i terminologjinë e riskut
- Shpjegim i elementëve përbërës të riskut
- Ushtrime: Vlerësim i ndikimit të gjasës
- Ushtrime: Menaxhimi i Riskut

**15:30 – 15:45 PUSHIM KAFEJE**

**15:45 - 17:00**

- Kapitulli D: Ndërgjegjësimi për riskun e mashtrimit
- Përkufizimi dhe shpjegimi i konceptit të mashtrimit
- Llojet e mashtrimit
- Treguesit e mashtrimit
- Mbyllje e ditës: Pyetje Përgjigje

## **DITA 2**

**9:00 - 10:30**

Pjesa III: Zhvillimi i angazhimeve të auditimit të brendshëm – Teknika dhe Instrumenta

- **Kapitulli A: Mbledhja e të dhënave dhe hartimi i procesit**
- Rishikimi i raporteve të mëparshme të auditimit dhe dokumente të tjera të vlefshme si pjesë e studimit të subjektit për t'u audituar
- Zhvillimi i listave dhe i pyetësorëve
- Zhvillimi i intervistave dhe shqyrtimit të hapave të procesit
- Mbledhja e të dhënave nëpërmjet vëzhgimit
- Vlerësimi i riskut për angazhimin e auditimit me qëllimi identifikimin e risqeve dhe kontrolleve kyçe Ushtrime: Vlerësimi i riskut për subjektin në auditim
- Zhvillimi i përzgjedhjes
- Hartimi dhe skicimi i procesit

**10:30 – 10:45 PUSHIM KAFEJE**

**10:45 – 12:30**

- **Kapitulli B: Vlerësimi i rëndësisë, mjaftueshmërsë, dhe cilësisë së evidencave**
- Identifikimi i burime të ndryshme të informacionit
- Vlerësimi i evidencës së mjaftueshme, kompetente dhe relevante
- **Kapitulli C: Analiza e të dhënave dhe intepretimi i tyre**
- Hyrje në koncept
- Përdorimi i instrumentave të kompjuterizuar dhe teknikave bashkëkohore
- Kryerja e analizës së tabelave së të dhënave
- Përdorimi i analizave statistikore
- Proceset e teknikave të kontrolleve
- Përdorimi i teknikave për rishikime analitike
- Kryerja e krahasimeve (Benchmarking)

**12:30 - 13:30 DREKA**

**13:30 – 15:30**

- **Kapitulli D: Dokumentacioni/Letra Pune**
- Zhvillimi i dokumentacionit/letrave të punës
- Rishikimi dhe kontrolli i dokumentacionit/letrave të punës
- Ushtrime: Ripërcaktimi i qëllimit të angazhimit

**15:30 – 15:45 PUSHIM KAFEJE**

**15:45 - 17:00**

- **Kapitulli E: Raportimi i të dhënave**
- Raportimi i rezultateve të testit tek udhëheqësi i skuadrës së auditimit
- Zhvillimi i konkluzioneve të lidhura me kontrollet
- Ushtrim: Zhvillimi i konkluzioneve
- Ushtrim: Zhvillimi i rekomandimeve
- Diskutime, pyetje dhe përgjigje

## **INSTRUKTORI – STAVRI PASHKO**

Stavri ka rreth 15 vjet eksperiencë profesionale në auditimin e brendshëm, menaxhimin e riskut, konsulencën dhe zhvillimin e biznesit, menaxhimin e projekteve dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Stavri ka eksperiencë në sektorin bankar në Shqipëri, ndërkohë që për momentin punon me risqe dhe kontrollet e brendshme në një kompani telekomunikacioni në Suedi. Ai është një nga themeluesit e Albanian Institute of Internal Auditors, ka qënë konsulent për llogari të organizatës SIGMA/OECD për përditësimin dhe ripërgatitjen e programit për certifikatën e “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Ai është pjesëtar i Komitetit të Anëtarëve për IIA Sweden si dhe është i angazhuar me institute dhe organizata të tjera në lidhje me bashkëpunime mbi fushën e auditimit të brendshëm. Stavri është diplomuar në Universitetin e Torinos, Itali dhe me një master të Universitetit të Malmö në Suedi. Ai është një auditues i brendshëm i certifikuar (CIA) dhe zotëron dhe certifikime të tjera të lidhura me menaxhimin e riskut dhe auditimit. Stavri është një trajnues i certifikuar nga për të dhënë trajnimet e përgatitura nga IIA (<http://www.learnia.com/classes-offered/>).

## TË DHËNA TË TJERA

Pjesëmarrja: **Anëtarë të AIIA 199 € / Jo anëtarë 239 €**

Në shumën e mësipërme përfshihen pjesëmarrja në kurs, materiale didaktike, dreka për ditët e pjesëmarrjes si dhe kafja në pushimet ndërmjetëse.

Pagesa\* mund të bëhet me transfertë bankare, ose me depozitë direkte duke përdorur të dhënat e mëposhtme:

Mbajtësi i llogarisë: **Albanian Institute of Internal Auditors**

Nr.llog: **0010039700 (EUR)**

Swift: **SGSBALTX**

IBAN: **AL43 2021 1123 0000 0000 1003 9700**

**Raiffeisen Bank Albania**

Nr.llog: **0000039700 (LEK)**

Swift: **SGSBALTX**

IBAN: **AL93 2021 1044 0000 0000 0003 9700**

**Raiffeisen Bank Albania**

Contact details: [iakosova@aia.al](mailto:iakosova@aia.al); [info@aia.al](mailto:info@aia.al)

*\* E rëndësishme: Shuma e transferuar duhet të përfshijë të gjithë shumën siç është përshkruar më lart. Pagesa administrative (si psh. tarifa për kryerjen e trasfertës bankare) apo të ngjashme nuk janë pjesë e detyrimit ndaj Albanian Institute of Internal Auditors.*

## Formular Pjesëmarrjeje

për

### CIA EXAM REVIEW PART 1

09 – 10 Prill 2018, Hotel Grand, Tiranë,.

Emri Mbiemri			
Pozicioni i punës			
Emri i institucionit		Fiskal nr	
Tel/Mob		Email	
Adresa			

#### Politika e anulimit të pjesëmarrjes:

Vendet në kurs janë të kufizuara ndaj AIIA ka një politikë mbi anulimin e pjesëmarrjes në këto kurse.

1. Në rast të anulimit të kursit nga AIIA apo nga një bashkëpunëtor i AIIA, ne do të lajmërojmë në kohë pjesëmarrësit 10 ditë para ngjarjes së kursit, edhe pse mund të ketë raste të rralla që kjo mund të mos jetë e mundur. Të gjitha tarifat e kursit do të rishpërblehen në tërësi, por jo pagesa të lidhura me çështje llogjistike si psh strehimi, udhëtimi, etj.
2. Nuk do ketë rikthim të shumës së paguar nëse
  - a. Pjesëmarrësi lajmëron për jo-pjesëmarrje në më pak se dy javë para trajnimit, përveç në raste të veçanta dhe në liri veprimi të Albanian Institute of Internal Auditors.
  - b. Pjesëmarrësi nuk paraqitet në trajnim.
3. Për prenotime të anuluar në më shumë se dy javë përpara ditës së parë të trajnimit, AIIA do të kthejë prapa 100% të shumës tek pjesëmarrësi.

- Konfirmoj që të dhënat e mia janë të vërteta dhe të sakta.
- Konfirmoj që lexova, kuptova programin e trajnimit dhe pranoj me dëshirën time të marr pjesë në këtë trajnim sipas kushteve të paraqitura.